

## EDITORIAL

### **Anthropologjia në Kosovë**

Arsim Canolli

Kryeredaktor

arsim.canolli@uni-pr.edu

Kosova është shtet i pavarur, por ende vazhdon të kërkojë legjitimitet në skenën globale. Ka një një histori politike të pasur dhe të kontestuar. Ndonëse është një vend i vogël, ka një trashëgimi kulturore që shtrihet nga koha e Neolitit deri te monumenti “Newborn”. Gjatë shekullit të kaluar, Kosova ka qenë skenë e zhvillimeve, ngjarjeve dhe ndryshimeve të mëdha shoqërore dhe politike. Pas luftës, ka kaluar nëpër koridorin e ngushtë të masave të shumta politike të paqëndrimit dhe shtetndërtimit, duke u ndërthurur, përshtatur dhe evoluar brenda kontekstit të saj të ri. Duke qenë e vendosur në udhëkryq dhe duke u zhvilluar në procesin e zgjatuar të shtetformimit, Kosova është temë shembullore për studime antropologjike. Pyetjet shtrohen: Si i rrah pulsi shoqërisë kosovare sot? Cila është historia kulturore e kësaj shoqërie dhe politike? Sa ka ndikuar e kaluara e saj të tashmen dhe në çfarë mase vazhdon të ushtrojë ndikim? Kur fillon identiteti politik dhe kulturor i Kosovës? Si lidhet Kosova me Shqipërinë dhe rajonin? Çfarë nënkupton investimi në shtetësinë dhe identitetin e Kosovës?

Për të kuptuar këto pyetje, antropologët vrojtojnë ndryshimet në kontekst të pyetjes: çfarë ndikimi kanë ndryshimet në përgjithësi dhe për shoqërinë e veçantë që shqyrtohet? Kështu, në jehonë të fjalëve të Clifford Geertz-it, hulumtimi në Kosovë është thelbësor për të kuptuarit antropologjik të Kosovës. Në kontekstin postsocialist të Evropës Juglindore, antropologjia ka ofruar diskutime të vazhdueshme që synojnë përcaktimin e natyrës, funksionit, efektit dhe performancës së ndryshimit. Antropologët kanë prodhuar monografi të shumta për Shqipërinë, Rumaninë, Serbinë, Bullgarinë, Malin e Zi dhe Kosovën, por edhe për vende të tjera që rrethojnë Evropën Juglindore. Këto vepra nxjerrin në pah, mes shumë tjerash, liminalitetin postkomunist, apo tematikat e shumta që përputhen me pyetjen e Katherine Verdery-t se “çfarë ishte socializmi dhe çfarë vjen më pas?”.

Deri në vitin 1912, Kosova dhe territoret e tjera rajonale të banuara me shqiptarë kanë qenë pjesë e Perandorisë Osmane. Më pas, në vitin 1912, Kosova u pushtua nga Serbia dhe, pas Luftës së Dytë Botërore, mbeti nën Jugosllavi. Në vitin 1989, Kosovës iu hoq autonomia, e cila i qe dhënë si rezultat i ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974. Pas një dekade qëndrese paqësore, shqiptarët filluan rezistencën ushtarake. NATO-ja

ndërhyri në vitin 1999 dhe Kosova u çlirua në qershor të po atij viti. Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj. Që atëherë, vendi ka qenë vazhdimisht i përfshirë në një *rit kalimi* në të gjitha fushat, duke kërkuar legjitimitet si një shoqëri sovrane politike dhe duke bërë ndryshime dhe rivitalizime, si shoqëri dhe kulturë. Por, shtrohet pyetja tjetër: Për çfarë rivitalizimi synohet? Kështu, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e Kosovës janë tema të rëndësishme në antropologjinë e Evropës, shtetndërtimit dhe modernitetit në përgjithësi.

Po nga ana historike, si është studiuar dhe përfaqësuar Kosova në fushën e antropologjisë? Kosova ka qenë në qendër të antropologjisë, udhëpërshkrimeve dhe letrave diplomatike që nga mesi i shekullit 19. Megjithatë, gjatë komunizmit jugosllav, pak antropologë të huaj vizituan vendin. Etnologjia shqiptare tumiri komunizmin për t'a arritur barazinë dhe promovuar në heshtje identitetin etnik/kulturor. Etnologjia jugosllave ishte e decentralizuar, por në Kosovë, etnologjia dhe historiografia serbe mbetën hegjemoniste në shkrimin dhe "shpjegimin" e çështjes shqiptare/kosovare, duke përdorur mite dhe stereotipa të ndryshme, të bazuara në shkrimet e fillimit të shekullit 20.

Antropologjia në Kosovë ka trashëguar traditën albanologjike të studimit të kulturës. Megjithatë, pas luftës së fundit (1998-1999), antropologjia hyri në një udhë të re epistemike, duke ngritur pyetje të reja dhe duke interpretuar gjetjet brenda kontekstit të qasjeve dhe teorive bashkëkohore, që përputhen me debatin bashkëkohor antropologjik në Perëndim. Këto qasje të reja janë artikuluar në Departamentin e Antropologjisë në Universitetin e Prishtinës, Institutin Albanologjik në Prishtinë, Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimin e Artit në Tiranë dhe Departamentin e Arkeologjisë dhe Studimeve të Trashëgimisë Kulturore në Universitetin e Tiranës. Ato dalin në pah në konferenca, seminare, shkrime dhe shkolla verore. Po ashtu, një numër antropologësh shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëria, të diplomuar në universitetet perëndimore, janë kthyer në institucionet vendore për të ofruar këto perspektiva të reja. Për më tepër, antropologët kanë filluar të punojnë së bashku me kolegë nga Evropa, Britania e Madhe dhe SHBA, si dhe vende të tjera, duke nisur projekte dhe bashkëpunime të shumta kërkimore dhe duke kontribuar në kërkimin antropologjik përmes botimeve të tyre. Gjatë verës së vitit 2023, arkeologët kosovarë që punojnë me homologët e tyre francezë, zbuluan mbishkrime monumentale që hedhin dritë mbi perandorin Justinian në Parkun Arkeologjik të Ulpianës, duke shënuar një hap të rëndësishëm në kërkimet arkeologjike në periudhën e antikitetit të vonë në rajon. Në dekadat e fundit janë realizuar një mori projektesh në antropologji kulturore dhe arkeologji dhe shumë të tjera janë duke vazhduar ende, në Kosovë dhe Shqipëri. Shumica janë projekte bashkëpunuese ndërmjet antropologëve vendës dhe homologëve të tyre evropianë dhe amerikanë. Ka pak bashkëpunime kërkimore rajonale, por ka vend për përmirësim në këtë drejtim.

Duhet theksuar se pavarësisht punës në institucione publike, pavarësisht një qasjeje nacionaliste në traditën etnografike dhe etnologjike nga regjimet komuniste, dhe pavarësisht faktit se vijnë nga shkolla evropiane dhe globale, antropologët shqiptarë nuk kanë zhvilluar një ideologji uniforme apo një botëkuptim njëdimensional në antropologji. Praktika e antropologjisë është kuptuar dhe zbatuar kryesisht si antropologji sociale/kulturore. Megjithatë, në vitet e fundit, Departamenti i Antropologjisë në Universitetin e Prishtinës (UP), që nga hapja e degës së arkeologjisë në vitin 2014, ka ndjekur një

qasje më gjithëpërfshirëse duke synuar një antropologji të katër fushave. S' do mend se, në disa këndvështrime, antropologjia ende imagjinohet, artikullohet dhe praktikohet si etnologji, e cila perceptohet si një "etnografi e kulturës etnike". Kjo qasje, në praktikë, shpesh bëhet njëfarë pedagogjie etnocentrike.

Në disa raste, arkeologët kanë vazhduar punën me historianët, dhe në të tjera, me antropologët social/kulturorë. Si rezultat, ka interpretime të shumta të antropologjisë shqiptare sot. Në Departamentin e Antropologjisë në Universitetin e Prishtinës (UP), në dekadën e kaluar ka dalë në pah një trajektoreje e veçantë e zhvillimit të antropologjisë. Konsiderohet se përfshin katër fusha të antropologjisë, por në praktikë, ka funksionuar vetëm me dy: antropologjinë kulturore dhe arkeologjinë. Megjithatë, ka potencial dhe interes për antropologjinë gjuhësore dhe me kuadrat e reja, antropologjia biologjike mbetet një degë për t'u hapur në të ardhmen.

Në antropologjinë bashkëkohore shqiptare po ndodh një ndryshim i dukshëm me asimilimin e pedagogjisë antropologjike perëndimore. Ky tranzicion paradigmatic karakterizohet nga një riinterpretim i mënyrës se si konceptohen temat e kërkimit. Ndryshe nga metodologjitë e mëparshme, të cilat shpesh ndikoheshin nga një etikë e veçantë nacionaliste ose nga direktivat shtetërore, qasjet pluraliste të antropologjisë shqiptare përfshijnë një spektër objektivash kërkimi e hulumtimi. Këta objektiva të larmishëm pasurojnë kolektivisht ligjërimin dhe avancimin e mendimit antropologjik. Nuk ka dyshim dhe duhet të nënvizohet se antropologjia shqiptare shfaq heterogjenitet të theksuar, që shfaqet në sfondet e ndryshme shkencore, prirjet tematike dhe këndvështrimet teorike të antropologëve individualë.

Antropologjia shqiptare e pasuron sot albanologjinë – shkencën kombëtare e fokusuar në studimin e gjuhës, historisë dhe kulturës shqiptare – me kontribute thelbësore në zgjerimin dhe rigjallërimin e saj. Ky angazhim karakterizohet nga dialogu dhe kritika e vazhdueshme, larg kulturës romantizuese. Dialogu ndërmjet albanologjisë, si një trup tradicional i njohurive, dhe antropologjisë, me metodologjitë, teoritë dhe këndvështrimet e saj të larmishme, është dialog dinamik dhe në zhvillim e sipër. Studimet aktuale antropologjike në Prishtinë dhe Tiranë shmangin paraqitjen e kulturës si një "etnokulturë" statike ose e pastër. Në vend të kësaj, antropologjia shqiptare e kundron kulturën si një proces të rrjedhshëm ndryshimi, shkëmbimi dhe transformimi, ashtu siç është vetë jeta.

Antropologjia shqiptare, e kryer në Kosovë dhe Shqipëri, shkon përtej hulumtimit të bërë nga antropologët shqiptarë; është një antropologji kushtuar studimit të shoqërive, kulturave dhe shteteve shqiptare, duke përfshirë edhe fqinjët dhe identitetet e tyre. Antropologjia bashkëkohore po zhvillohet për të përfshirë të gjithë ata që studiojnë tema të lidhura me shqiptarët dhe jetën e tyre dhe më gjerë, duke ruajtur një perspektivë të re antropologjike pa paragjykime etnike. Qëllimi kryesor i antropologjisë, në përgjithësi, është të hulumtojë dhe të njoh marrëdhëniet njerëzore. Në kontekstin e shoqërive, kulturave dhe ndërveprimeve shqiptare, synimi është të hulumtohen marrëdhëniet interkulturore-shoqërore dhe intrakulturore-shoqërore shqiptare. Studiuesit që kryejnë studime antropologjike në vende të ndryshme kontribuojnë në një mozaik idesh të ndërlidhura, për të ofruar një kuptim gjithëpërfshirës se si funksionojnë shoqëritë shqiptare.

Më poshtë do të nënvizoj disa veçori të antropologjisë bashkëkohore shqiptare, të cilat mund të mos jenë përfundimtare, por synojnë të nxisin diskutime të mëtejshme.

Së pari, antropologjia në Kosovë dhe Shqipëri përballet me konceptin e “antropologjisë në shtëpi”. Antropologët bashkëkohorë ndërmarrin kërkime brenda shoqërisë së tyre. Shpesh, ata përdorin një qasje metodologjike që sprovon “ekzaminimin e kulturës nga këndvështrimi i një të huaji” ose “si një i huaj mund t’i qaset asaj”. Kjo qasje përfshin një formë simulimi për të nxitur një ndjenjë delikate të shkëputjes apo distancës, duke tentuar për ta parë kulturën lokale si “të dallueshme” ose “tjetër”. A mund t’i klasifikojmë antropologët si “vendës” ose “të huaj”? A është kjo një relik e së kaluarës apo ka rëndësi? Debatet mbi këtë temë shpesh japin argumente të polarizuara dhe konferencat shpesh karakterizohen nga tensioni kur trajtohen çështjet e “distancës”, marrjet e “roleve”, veprimet si “si vendës” ose distancimet “si një i huaj që mbetet i shkëputur”. Pësia e këtij debati vazhdon të jetë e rëndësishme. Megjithatë, është thelbësore të pranohet se të gjithë antropologët, madje edhe arkeologët që eksplorojnë kulturën materiale, janë “mysafirë që ka ngë të gjatë” në shtëpitë dhe jetën e atyre që studiojnë.

Së dyti, antropologjia shqiptare po përparon drejt fushave kërkimore të reja dhe pjellore, duke përfshirë studimin e së përditshmes, të përditshmërisë, subkulturave dhe temave të shumta të konsideruara tradicionalisht “jomonumentale” brenda traditës albanologjike. Ajo po eksploron gjithnjë e më shumë skajet, kufirin dhe dinamikën e transformimeve shoqërore. Këtij ndryshimi i ka dhënë kahje qasja bashkëkohore epistemike që antropologët përdorin në kërkimin e tyre, por edhe angazhimi i tyre për të “thërmuar” dhe ribashkuar kulturën, për ta interpretuar në ndërlidhje të ndryshme: duke vënë kllapa, duke e veçua një aspekt, duke vëzhguar nga një perspektivë e re, duke e rilidhur dhe interpretuar në mënyrë të re objektin e studimit.

Së treti, antropologjia është në përpjepje të vazhdueshme për të interpretuar të kaluarën brenda kontekstit të së tashmes. E kaluara është një bashkim kompleks i shtresave të shumta, shpesh të paqarta, veçanërisht nga një perspektivë moderne. Përgjatë historisë së albanologjisë, shtresa të ndryshme të së shkuarës janë interpretuar në shkallë të ndryshme - disa minimalisht, të tjera gjerësisht, disa sipërfaqësisht dhe disa pothuajse fare. Rrjedhimisht, antropologët ndeshen me sfida në ndërtimin e një rrëfimi koherent historik. Si duhet ta segmentojmë të kaluarën? A ndahet në epoka socialiste, osmane, ilire, bizantine, urbane apo rurale? A mund të përputhet përpikërisht e kaluara në këtë tipologji? Ndërkohë që antropologjia mund të përdorë “vija të trasha” për të përcaktuar subjektin e saj të studimit, lind pyetja: a duhet antropologjia të imponojë klasifikime të ngurta dhe të paracaktojë tema? Antropologët përballet me detyrën e madhe të interpretimit të së kaluarës në të tashmen, detyrë kjo e ndërlidhur nga pasiguritë e natyrshme rreth interpretimit të epokave historike. Megjithatë, qasjet e reja metodologjike dhe teknologjike kërkimore në fushat e arkeologjisë dhe gjuhësisë po hapin fusha të reja kërkimi për vështrimin antropologjik.

Si përshtatet *Kosova Anthropologica* në perspektivën e antropologjisë shqiptare?

*Kosova Anthropologica* është themeluar me qëllim të nxitjes së një vështrimi të ri antropologjik mbi temat tradicionale dhe bashkëkohore. Misioni ynë është të inkurajojmë kërkime origjinale në fushën e antropologjisë, me fokus në Kosovë dhe në rajonin e gjerë. Revista shërben si një platformë për dialog midis studiuesve me

përvojë dhe atyre në zhvillim në disiplina të ndryshme antropologjike, duke përfshirë antropologjinë sociale/kulturore, arkeologjinë dhe antropologjinë gjuhësore. Për më tepër, ne mirëpresim hulumtimet empirike në antropologji biologjike, mikrosociologji dhe histori kulturore. Objektivi ynë është të zgjerojmë sferën e njohurive antropologjike për Kosovën dhe vendet fqinje, duke mirëpritur kontributet e studiuesve vendës dhe ndërkombëtarë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Revista boton artikuj në të dyja gjuhët. *Kosova Anthropologica* është revistë e shqyrtuar dhe redaktuar nga kolegët (ang: *peer-reviewed*) që përpiqet të jetë model i antropologjisë gjithëpërfshirëse, brenda Kosovës dhe rajonit.

Në këtë botim nistor, ne kemi marrë dorëshkrime nga një sërë autorësh të ndryshëm, kryesisht studiues në fille të karrierës, të cilët janë angazhuar në punë terreni brenda Kosovës dhe Shqipërisë. Ekipi redaktues ka përzgjedhur të botojë katër ese shkencorë dhe një recension libri, të cilat kanë përmbushur me sukses kriteret e revistës. Të gjithë esetë, duke përfshirë edhe recensionin e librit, janë vlerësuar/redaktuar nga të paktën dy recensentë anonimë.

Në esenë e parë, arkeologët Elic Weitzel, Erina Baci dhe Dan Plekhov japin një pamje kritike të demografisë fisnore në Shqipërinë e Veriut gjatë fillimit të shekullit të 20-të, duke argumentuar se faktorët gjeografikë kishin fuqi të kufizuar ndikuese në madhësinë e popullsisë së fiseve veriore shqiptare të fillimit të shekullit të 20-të dhe se faktorë të tjerë të pamatur si pasuria apo konfliktet historike mund të kenë qenë më ndikues.

Kailey Rocker, antropologe amerikane, analizon se si Shqipëria përdor përkujtimoret e Holokaustit për të përshtatur historinë e saj me Holokaustin dhe epokën e saj socialiste, duke theksuar portretizimin e saj si një strehë e sigurt për hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe kujtimin e një kampi famëkeq internimi, për ta lidhur narrativën kombëtare me një kulturë më të gjerë evropiane të kujtesës.

Arbër Jashari, antropolog nga Kosova, diskuton se si, gjatë shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë në vitet 1990, shumica shqiptare në Kosovë adoptoi një rezistencë civile dhjetëvjeçare të bazuar në vlerat morale tradicionale dhe një etikë solidariteti, duke u fokusuar në praktikën e faljes, dëgjimit dhe pritjes, si praktika qendrore për etosin e lëvizjes.

Në artikullin e saj, historiania e artit Drita Bruqi Kabashi përdor qasje antropologjike për të interpretuar artefaktin “Hyjnesha në Fron” në Muzeun Kombëtar të Kosovës, duke analizuar rëndësinë e tij historike dhe bashkëkohore, kuptimet e kundërta dhe rolin e këtij artefakti si një simbol kulturor modern, gjithnjë duke e parë përmes thjerrëzave të fabulacionit kritik dhe poezisë.

Në recensionin e tij për librin “Shkatërrimi i kujtesës: Arkitektura në luftë” të Robert Bevanit, përkthyer në shqip nga Florina Jerliu, Bekim Baliqi përshkruan eksplorimin e Bevanit në temën e shkatërrimit të qëllimshëm të trashëgimisë arkitekturore dhe kulturore në kohë luftërash, duke argumentuar se akte të tilla nuk janë thjesht dëme kolaterale, por përpjekje të qëllimshme për të fshirë kujtesën dhe identitetin e komuniteteve, duke përfshirë një gamë të gjerë kontekstesh historike dhe gjeografike.

*Kosova Anthropologica* është një dëshmi e përpjekjes dhe pasionit tonë kolektiv për punën shkencore. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për redaktorët e *Kosova Anthropologica* – Michael Galaty, Nebi Bardhoshi, Arben Hajdari, Christophe Goddard

dhe Tahir Latifi – për punën e madhe që kanë bërë në përpilimin e revistës. Përkushtimi dhe përpjekjet e tyre të palodhura në vendosjen e standardeve të larta të revistës janë për çdo lavdatë. Përkushtimi i tyre ndaj hollësive dhe zelli për përsosmëri pasqyrohet në këtë numër të parë të revistës. Gjithashtu do të doja të falenderoja Rozafa Berishën, asistenten e redaksisë, për ndihmën që ka ofruar për mua, për redaktorët dhe për autorët.